



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE**

**STATUT I BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE**

(Ndryshuar me Vendimin nr. 63 datë 04.08.2020)

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti i Statutit**

Ky statut përcakton parimet bazë të organizimit dhe administrimit institucional, administrativ dhe operacional të BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE (më poshtë referuar “Bordi”, “Autoriteti” ose “BMP”).

**Neni 2  
Baza ligjore dhe personaliteti juridik**

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike ushtron veprimtarinë e tij në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, (referuar më poshtë “Ligji” ose “Ligji për Auditimin”) dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Bordi ka statusin e një autoriteti rregullator të pavarur dhe gëzon pavarësi operationale nga çdo subjekt tjetër, në zbatim të dispozitave të ligjit.

**Neni 3  
Vula dhe logo**

1. Bordi identifikohet me logon dhe vulën e tij zyrtare.
2. Logo dhe vula zyrtare përdoren së bashku me nënshkrimet e autorizuara nga Bordi.
3. Deri në momentin e përgatitjes së logos identifikimi bëhet përmes vulës. Në momentin e përgatitjes dhe aprovimit të logos nga Bordi, karakteristikat dhe përshkrimi i saj duhet të specifikohen në një vendim të posaçëm prej Bordit.
4. Vula aprovohet nga kryetari i Bordit.
5. Logo dhe vula zyrtare përdoren në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## **KREU II**

### **MISIONI, ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I BORDIT**

#### **Neni 4** **Misioni**

Misioni i Bordit të Mbikëqyrjes Publike është mbikëqyrja publike e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, organizatave profesionalë të audituesve ligjorë si dhe organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar me qëllim përmbushjen e objektivave publik në mbështetje dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, kuadrit rregullator dhe në shërbim të interesit publik.

#### **Neni 5** **Organizimi**

1. Organet e Bordit të Mbikëqyrjes Publike janë:
  - a) Anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
  - b) Kryetari i Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
  - c) Drejtori Ekzekutiv dhe Struktura Mbështetëse;
  - ç) Komisionet, komitetet, këshillat dhe grupet e punës që ngrihen, sipas rastit, me vendim të Bordit Mbikëqyrjes Publike ose me rregullore apo akte të veçanta.

#### **Neni 6** **Anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike**

1. Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave, me një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë, si më poshtë:
  - a) kryetari dhe tre anëtarë propozohen nga Ministri i Financave, njëri prej të cilëve përzgjidhet nga institucionet e arsimit të lartë;
  - b) një anëtar propozohet nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.
2. Procedurat e përzgjedhjes dhe shkarkimit të tyre përcaktohen nga Ligji dhe VKM nr 786 datë 9.11.2016.

#### **Neni 7** **Mbledhja dhe vendimmarrja e Bordit**

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës.
2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në bazë të Ligjit, nëpërmjet mbledhjeve të anëtarëve të tij dhe marrjes së vendimeve në përputhje me procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike të përcaktuara në Ligj dhe në VKM nr 786 datë 9.11.2016. Mbledhjet e bordit zhvillohen në vendin e përcaktuar në shkresën e thirrjes. Bordi, si rregull, zhvillon një mbledhje në muaj, por mund të mbledhet sa herë që ka çështje të rëndësishme, që duhet të shqyrtohen.
3. Thirrja e mbledhjes bëhet nga kryetari i bordit, i cili vendos datën, rendin e ditës dhe orën. Në mungesë të tij vetëm me miratim dhe porosi të nënshkruar të kryetarit, mbledhja mund të thirret nga anëtarë të tjerë në detyrë dhe, në mungesë të tij, nga anëtarë të tjerë në moshë.

4. Si rregull i përgjithshëm Bordi i Mbikëqyrjes Publike nuk mund të mbledhet pa prezencën e Kryetarit. Si përjashtim nga ky rregull, në raste të veçantë:
  - a. urgjente dhe tepër të rëndësishme Bordi i Mbikëqyrjes Publike mund të mbledhet pa prezencën e Kryetarit vetëm nëse Kryetari delegon me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (të nënshkruar) zëvendësimin e tij vetëm për një mbledhje në përputhje me axhenden e mbledhjes.
  - b. në rastet e përmendura në pikën 12 të nenit 7
5. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen e bordit, kur kjo kërkohet me shkrim nga, të paktën, 1/3 e anëtarëve, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjes, në këtë rast, bëhen brenda 10 (dhjetë) ditëve pune pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve dhe, të paktën, brenda 5 (pesë) ditëve pune para datës së caktuar për mbledhje.
6. Lajmërimi për thirrjen e mbledhjes duhet të tregojë qartë dhe me hollësi çështjet, që do të diskutohen dhe dokumentacionin përkatës. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar i bordit jo më vonë se 2 (dy) ditë pune përpara zhvillimit të mbledhjes.
7. Mbledhja drejtohet nga kryetari i Bordit. Mbledhja e Bordit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve së bashku me prezencën e kryetarit. Në rastin kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve ose kryetari mbledhja shtyhet për një ditë tjetër. Kryetari vendos thirrjen e saj në një ditë tjetër, jo më afër se 24 (njëzet e katër) orë pas mbledhjes së anuluar. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, përveç rasteve kur për marrjen e vendimit, nga statuti ose rregulloret e veçanta, kërkohet shumicë e cilësuar (pra katër të pestat e të gjithë anëtarëve). Në rast barazie votash, vota e kryetarit është vendimtare. Bordi merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.
8. Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Ato duhet të jenë të argumentuara dhe, në çdo rast, vendimet kundër duhet të shpjegohen.
9. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, me shkrim, i cili përmban një përmbledhje të të gjithë procesit, por pa u kufizuar në opinione të anëtarëve, të dhëna për datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, arsyetimin, vendimet që u morën, si dhe rezultatit e votimeve. Procesverbali mbahet nga struktura mbështetëse e bordit dhe duhet të paraqitet për nënshkrim të të gjithë anëtarët në përfundim të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.
10. Bordi mund të përcaktojë rregulla të hollësishme për procedurat specifike të punës për raste e çështje të caktuara.
11. Bordi i Mbikëqyrjes Publike, miraton me jo më pak se katër vota pro të të gjithë të anëtarëve të tij, ndryshimet e Statutit.
12. Anëtar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike ka të drejtën e një vote, vetëm kur është i pranishëm personalisht në mbledhje. Si përjashtim nga ky rregull, në raste të veçantë, urgjente e tepër të rëndësishme sipas parashikimeve në rregulloret përkatëse, Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton vendime edhe pa u mbledhur, nëpërmjet votimit me shkrim dhe dërgimit të votës përmes mjeteve të sigurta të komunikimit të teknologjisë së informacionit (vendime qarkulluese).

13. Në raste të jashtëzakonshme kur mbledhja e kërkuar me shkrim nga 1/3 e anëtarëve të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni dështon të mbledhet sipas përcaktimeve të pikës 6 të këtij neni dhe mbledhja e radhës nuk thirret brenda 30 ditësh pune nga kryetari sipas përcaktimeve të 6 atëherë mbledhja mund të thirret edhe me kërkesë të 1/3 së anëtarëve të Bordit. Në këtë rast për të ruajtur objektivitetin drejtuesi organizativ i mbledhjes do të jetë një person përgjegjës nga struktura mbështetëse i cili do të përcaktohet me votim në fillim të mbledhjes sipas propozimeve të sjella nga secili anëtarë. Personi që do caktohet për të drejtuar mbledhjen nuk do të ketë të drejta vendimmarrje dhe roli i tij do të jetë i kushtëzuar vetëm për organizimin dhe monitorimin e trajtimit të të gjitha pikave të trajtuara në kërkesën e thirrjes për mbledhje të jashtëzakonshme si dhe dokumentimin dhe regjistrimin e saktë të të gjitha minutave të mbledhjes.

## **Neni 8**

### **Kompetencat e Bordi të Mbikëqyrjes Publike**

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike, gjatë funksionimit të tij, ushtron kompetenca administrative dhe funksionale.
2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike ushtron kompetencat e mëposhtme administrative;
  - a) miraton logon zyrtare të Autoritetit, mënyrën e përdorimit, si dhe ndryshime të plota ose të pjesshme të saj;
  - b) miraton organikën e Strukturës Mbështetëse
  - c) shfuqizohet
  - ç) harton dhe miraton akte nënligjore me efekt rregullator dhe udhëzues ;
  - d) miraton pasqyrat financiare vjetore të Autoritetit;
  - dh) shfuqizohet
  - e) miraton rregulloren e Strukturës Mbështetëse
  - ë) miraton raportin e vlerësimit strukturës mbështetëse përputhje me përcaktimet e rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e strukturës mbështetëse;
  - f) miraton krijimin e komiteteve dhe komisioneve të specializuara, që mund të kenë në përbërje ose jo anëtarët të Bordit, punonjësit e Strukturës Mbështetëse, dhe specialistë të jashtëm.
3. Në zbatim të ligjit, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ushtron kompetencat e mëposhtme funksionale:
  - a) harton rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale dhe të Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, të cilat i paraqiten për miratim autoriteteve të parashikuara në këtë ligj;
  - b) mbikëqyr, monitoron dhe vlerëson zbatimin e procedurave të testimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese;
  - c) miraton formatin e regjistrimit publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese, të regjistruara nga Komiteti i Regjistrimit, si dhe mbikëqyr respektimin e rregullave, në lidhje me numrin e identifikimit të audituesve ligjorë në regjistër;
  - ç) miraton kodin e etikës të audituesve ligjorë e të shoqërive audituese, të përgatitur dhe të propozuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe mbikëqyr zbatimin e standardeve të këtij kodi;
  - d) mbikëqyr kontrollin e cilësisë, që realizohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
  - dh) mbikëqyr programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të audituesve ligjorë;
  - e) miraton rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore;
  - ë) kur e gjykon të nevojshme, kryen investigime shtesë për audituesit ligjorë dhe shoqëritë

- audituese;
  - f) shqyrton dhe merr vendim për ankesat e bëra nga kandidatët, në lidhje me regjistrimin e tyre;
  - g) miraton dhe publikon programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarive të tij; gj) shqyrton dhe merr vendim për rastet e shkeljeve disiplinore, që janë kompetencë e tij;
  - h) shqyrton dhe merr vendim për aspekte apo çështje të tjera, të parashikuara në Ligjin për Auditimin, që janë brenda objektit të veprimtarisë së tij.
  - i) teknike që ai i gjykon të nevojshëm apo të dobishëm për të përmbushur objektivat e veta.
  - j) Te tjera aktivitete, të përcaktuara në ligj dhe aktet ligjore dhe nënligjore
4. Bordi miraton statutet e të gjitha organizatave profesionale anëtarët e të cilave kryejnë shërbime në fushën e kontabilitetit dhe mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e tyre.

## Neni 9

### Kryetari i Bordit të Mbikëqyrjes Publike

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike kryesohet nga Kryetari. Të drejtat dhe detyrimet e Kryetarit janë:
  - a) të përfaqësojë dhe shprehë qëndrimin e Bordit në marrëdhënie me të tretët dhe për këtë përfaqësim të informojë Bordin;
  - b) të caktojë dhe ndjekë në mënyrë të vazhdueshme realizimin e detyrave të ngarkuara prej tij ose nga mbledhja e Bordit;
  - c) të planifikojë dhe realizojë mbledhjet për analiza periodike ose tematike mbi punën e Bordit. Këtë funksion Kryetari mund ta delegoj përmes një vendimi brenda Strukturës;
  - ç) të nënshkruajë vendime, akte të dala nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
  - d) të tjera kompetenca të përcaktuara në ligj, në aktet normative ,në këtë statut apo në rregullore të tjera të dala prej BMP.
  - dh) shfuqizohet
  - e) Në përputhje me VKM nr. 786 datë 9.11.2016 kryetari i bordit, 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të mandatit, për rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 1, të këtij kreu, njofton, me shkrim, ministrin e Financave për përfundimin e mandatit të anëtarit/anëtarëve;
  - ë) miraton ndryshimin e vendndodhjes së selisë së Autoritetit në Tiranë.
2. Kryetari i Bordit mund të propozojë kandidatë midis anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike për pozicionin e Nën Kryetarit të Bordit, pozicion i cili zgjidhet nga anëtarët e Bordit. Detyrat kryesore të Nën Kryetarit të Bordit janë si më poshtë si dhe detyra shtesë që mund t'i caktojë Kryetari i Bordit:
  - a) Asiston dhe mbështet Kryetarin për përmbushjen e detyrave të tij.
  - b) Me kërkesë të kryetarit asiston dhe mbështet Kryetarin e Bordit për tu siguruar se të gjithë Anëtarët e Bordit, janë plotësisht të informuar mbi raportimet periodike të përcaktuara në këtë statut, ligj apo rregullore të veçanta të miratuara nga Bordi përgjatë procesit të vendimmarrjes.
  - c) Të mbështesë dhe inkurajojë Bordin për të arritur misionin, vizionin, qëllimet dhe objektivat e institucionit.
  - ç) Mund të asistojë në detyra të tjera të caktuara nga Kryetari.

## Neni 10

### Struktura Mbështetëse

1. Në përputhje me nenin 4, pika 8 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton organikën dhe strukturën mbështetëse në funksion të përmbushjes së funksioneve të veta në përputhje me praktikatat më të mira të institucioneve homologe;
2. Struktura Mbështetëse ngrihet si pjesë organizative e pandashme në mbështetje të Bordit të Mbikëqyrjes Publike përgjatë procesit të përmbushjes së funksioneve të veta;
3. Në funksion të përmbushjes së veprimtarive që lidhen me administrimin e autoritetit brenda Strukturës Mbështetëse emërohet një Drejtor Ekzekutiv, sipas përcaktimeve të rregullores për organizimin dhe funksionimin e strukturës mbështetëse. Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së përditshme të autoritetit, organizimin e punës dhe detyrave të personelit të strukturës mbështetëse.
4. Drejtori Ekzekutiv emërohet me një afat 7 vjeçar nga BMP, me të drejtë riemërimi sipas përcaktimeve të rregullores për strukturën mbështetëse.

## Neni 11

### Komisionet, komitetet, këshillat dhe grupet e punës që ngrihen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike

1. Bordi Mbikëqyrjes Publike, me vendim ose rregullore të veçantë, mund të krijojë komitete, komisione, këshilla dhe grupe pune të përkohshme dhe të përhershme në mbështetje të veprimtarisë së strukturës mbështetëse dhe rolit të vet mbikëqyrës, si dhe rrjedhë e ligjeve të tjera në fuqi që lidhen drejtpërdrejt apo indirekt me Bordin e Mbikëqyrjes Publike.
2. Komitetet, komisionet dhe këshillat mund të ngrihen lidhur me çështje të :
  - kontrollit të cilësisë;
  - edukimit dhe kualifikimit të vijueshëm të profesionistëve kontabël;
  - investigimit dhe disiplinës;
  - pajtueshmërisë ligjore;
  - raportimit financiar;
  - etikës;
  - parandalimit dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
  - kontrollit të brendshëm;
  - studimore, kërkimore, akademike, publikimi;
  - çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e bordit apo që i shërbejnë bordit për të ushtruar kompetencat e veta.
3. Bordi i Mbikëqyrjes Publike përcakton të drejtat e veprimtarisë së tyre me vendim ose me rregullore të veçanta.
4. Përbërja e secilit prej këtyre komiteteve apo komisioneve të cilat do të krijohen në përputhje me këtë statut duhet të kenë së paku 3 anëtarë dhe së shumti 7 anëtarë.

5. Përzgjedhja dhe pagesat e anëtarëve të komisioneve dhe komiteteve të përkoshme dhe të përherëshme apo grupeve të punës përcaktohen me vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike ose rregulloren përkatëse për ngritjen dhe funksionimin e komisionit ose komitetit.

### **KREU III**

#### **VEPRIMTARIA EKZEKUTIVE**

##### **Neni 12**

##### **Veprimtaria e Autoritetit Rregullator**

Autoriteti funksionon nëpërmjet strukturës mbështetëse dhe njërive organizative në përputhje me strukturën e miratuar me vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike si dhe Bordit i Mbikëqyrjes Publike si organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës për veprimtarinë e autoritetit.

##### **Neni 13**

##### **Personeli**

1. Marrëdhëniet e punës të personelit të Strukturës Mbështetëse rregullohen nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, ky statut dhe aktet e tjera të nxjerra nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
2. Anëtarët e personelit punësohen dhe stimulohen në bazë të parimeve të kualifikimit, transparencës, barazisë së palëve dhe jo diskriminimit.

##### **Neni 14**

##### **Nënshkrimet e autorizuara**

1. Bordi përfaqësohet dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime nëpërmjet nënshkrimeve të autorizuara bazuar në dispozitat e këtij statuti, vendimeve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike apo të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, ose marrëdhënieve kontraktore me të tretë.
2. Nënshkrimet e autorizuara janë i vetmi element juridik i vlefshëm i përfaqësimit për administrimin dhe drejtimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

##### **Neni 15**

##### **Konfidencialiteti**

1. Anëtarët e bordit, gjatë ushtrimit të detyrës, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe informacionin që sigurohet prej tyre dhe të mos i përdorin ato për interesa personale.
2. Kryetari dhe anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe personeli i Strukturës Mbështetëse administrojnë informacionin konfidencial të përfituar nga kryerja e detyrave në përputhje me dispozitat e ligjit, aktet nënligjore të Autoritetit, si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **KREU IV MENAXHIMI FINANCIAR**

### **Neni 16 Financimi i BMP dhe Administrimi i mjeteve financiare**

1. Financimi i aktivitetit të Bordit bëhet në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar.
2. Në mbështetje të ligjit Bordi miraton “Rregulloren e mbledhjes së të ardhurave” e cila do të shërbejë në funksion të gjenerimit të të ardhurave për financimin e aktivitetit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
3. Bordi i Mbikëqyrjes Publike administron të ardhurat e realizuara në përputhje me dispozitat e ligjit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe rregulloret e funksionimit të BMP dhe në rregulloren e funksionimit të Strukturës së vet mbështetëse dhe rregulloreve të lidhura me funksionimin e komisioneve, komiteteve, këshillave, grupeve të punës të ngritura prej Bordit të Mbikëqyrjes Publike si dhe rregulloreve të veçanta të lidhura me mbarëvajtjen e aktivitetit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

## **KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 17 Raportimi**

1. Bordi i dërgon Ministrin të Financave, një herë në vit, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, një raport me shkrim, në të cilin bëhet një përmbledhje e jepen detaje për problemet e hasura nga audituesit ligjorë, masat e marra dhe zgjidhjet e dhëna.
2. Raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

### **Neni 18 Informimi i publikut**

1. Struktura Mbështetëse përpunon në vazhdimësi informacionin që do publikohet në faqen zyrtare të internetit në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret e nxjerra prej Bordit të Mbikëqyrjes Publike ku ndër të tjera dhe më së paku do të paraqitet:
  - a) Veprimtaria e Bordit dhe Strukturës Mbështetëse;
  - b) Legjislacioni dhe kërkesat ligjore të cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e bordit dhe të të gjitha subjekteve të Ligjit për Auditimin;
  - c) Rregulloret dhe vendimet e nxjerra nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike me karakter të përgjithshëm dhe në zbatim të kërkesave ligjore;
2. Bordi ka të drejtë të përcjellë informacione edhe nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit publik, si dhe të publikojë broshura, fletëpalosje etj.



**Neni 19**  
**Publikimi dhe përpunimi i të dhënave**

1. Struktura Mbështetëse mbledh, përpunon dhe publikon statistika lidhur me aktivitetin e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit si dhe organizatave profesionale, me qëllim krijimin e evidencave të nevojshme për administrimin dhe mirë rregullimin e tregut.
2. Dërgimi i statistikave në institucione të tjera financiare ose studimore bëhet në bazë të marrëveshjeve të lidhura me këto institucione për shkëmbimin e informacionit, ose në mungesë të tyre, në bazë të kërkesës së institucionit të interesuar dhe me miratim të Kryetarit të Bordit apo personelit të strukturës mbështetëse të autorizuar prej tij, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Neni 20**  
**Dispozita kalimtare**

1. Aktet e nxjerra nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, para hyrjes në fuqi të këtij statuti, do të vazhdojnë të zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me ligjin dhe me këtë statut si dhe me rregulloret e reja të miratuara nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Këto akte mund të shfuqizohen vetëm nga organi që i ka nxjerrë.
2. Të gjitha çështjet që nuk përcaktohen në këtë statut do të rregullohen sipas legjislacionit në fuqi ose përmes rregulloreve të veçanta të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
3. Ky statut është i disponueshëm për publikun në çdo kohë. Statuti publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

**Neni 21**  
**Hyrja në fuqi**

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij statuti, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Drejtori Ekzekutiv, Struktura Mbështetëse, si dhe të gjitha komisionet, komitetet apo grupet e punës të ngritura në zbatim të Ligjit Nr. 10091, datë 05.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, si dhe aktet nënligjore dhe kuadri rregullator në fuqi.

Ky statut hyn në fuqi menjëherë.